



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 21.03.2023

Nr: 31

Ora: 13:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 36 TË PARTISË
DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 21.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Sali Berisha

OBJEKT:

- Kundërshtim i vendimit nr. 179, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mbi zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.03.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, për regjistrimin e “Partisë Demokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.
- Ndryshimi i këtij vendimi, duke pezulluar regjistrimin e subjektit “Partia Demokratike” me nënkryetar z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

të datës 14 maj 2023, deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar për ankimimin e subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë” e përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 10, dhe 17 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 36 regj., datë 20.03.2023. Në mbledhjen e datës 21.03.2023, ora 13:00, pas relativitetit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 36 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, dhe 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 36, datë 20.03.2023, të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 23.03.2023, ora 13:00.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis Çefa	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar